



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Performancës

MENAXHIMI I PARKINGJEVE PUBLIKE NË QYTETIN E PRISHTINËS NGA NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE PRISHTINA PARKING

Prishtinë, gusht 2024

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetuta dhe Ligji¹ i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur, i cili e ndihmon Auditorin Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj. Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të kontribuojmë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000²).

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë³, efikasitetit⁴ dhe efektivitetit⁵ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit të performancës “Menaxhimi i parkingjeve publike në qytetin e Prishtinës nga Ndërmarrja Publike Lokale Prishtina Parking”, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme, Myrvete Gashi Morina, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Samir Zymberi, Drejtor i Departamentit të Auditimit

Labinot Sadiku, Udhëheqës i Ekipit

Gëzim Krasniqi, Anëtar i Ekipit

Alba Keqa Bejtullahu, Anëtare e Ekipit

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - Adresa: Rr. Ahmet Krasniqi nr. 210, Lagjja Arbëria, Prishtinë 10000, Kosovë
Tel: +383(0) 38 60 60 04/1011
<http://zka-rks.org>

1 Ligji 05_L_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

2 Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike

3 Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm.

4 Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.

5 Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje e përgjithshme	1
1. Hyrje	5
2. Objektiva dhe pyetjet e auditimit	9
3. Gjetjet e auditimit.....	11
3.1.Planifikimi dhe lëshimi i lejeve të parkimit nga Prishtina Parking janë jo efektive	12
3.1.1. Ndërmarrja ka lëshuar leje parkimi për qytetarët të cilët nuk kanë plotësuar kriteret e banorit rezident	12
3.1.2. Anulimi i gjobave nuk evidentohet në sistemin e brendshëm të Ndërmarrjes	19
3.1.3. Parkingjet me lara karakterizohen me mungesë të digjitalizimit	21
3.2.Mungon shenjzimi i zonave të caktuara në Kryeqytet	24
3.3.Mbikëqyrja e kontrollorëve nga Dispeçeret përcjellët me mangësi dhe nuk evidentohet	27
3.3.1. Inspektimet joefektive nga Inspektorati i Komunës së Prishtinës	28
3.3.2. Mos barazimet ditore të të hyrave nga pagesat e shfrytëzimit të parkingjeve me lara.....	30
3.3.3. Mungesa e analizave gjatë hartimit të rregulloreve	31
4. Konkluzionet	33
5. Rekomandimet.....	37
Shtojca I: Kriteret, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	41
Shtojca II: Lejet e Parkimit të lëshuara nga Prishtina Parking dhe mungesa e kriterëve	47
Shtojca III: Letër konfirmimi	62

Lista e shkurtesave

DI	Drejtoria e Inspektoratit
DO	Departamenti i Operimit
DZHB	Departamenti i Zhvillimit të Biznesit
KP	Komuna e Prishtinës
LP	Lejet e Parkimit
NPL	Ndërmarrja Publike Lokale
PH	Parkingjet e Hapura
PL	Parkingjet me Laura
PP	Prishtina Parking

Sqarim: Në rregulloren e vjetër të Ndërmarrjes janë parashikuar Gjoha për qytetaret të cilët nuk respektojnë rregullat për shfrytëzim të parkingut. Me rregulloren e re të Ndërmarrjes të vitit 2024, gjohat janë zëvendësuar me Bileta 24 orëshe. Në brendi të raportit jemi referuar Gjoha kur bëhet fjalë gjatë periudhës së zbatimit të rregullores së vjetër dhe Bileta 24 orëshe për periudhën e zbatimit të rregullores së re.

Përmbledhje e përgjithshme

Menaxhimi i parkingjeve është një komponent kritik i infrastrukturës urbane, i cili luan një rol kyç në jetën e përditshme të banorëve dhe vizitorëve në Komunën e Prishtinës. Ndërmarrja Publike Lokale Prishtina Parking është autoriteti kryesor për organizimin dhe menaxhimin e parkingjeve publike e cila ka për qëllim që të ofroj shërbime të parkingjeve për qytetarët në Kryeqytet.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës për të vlerësuar efikasitetin dhe efektivitetin e shërbimeve të ofruara për qytetarët nga Ndërmarrja Prishtina Parking. Po ashtu, të vlerësojmë masat dhe veprimet në menaxhimin e parkingjeve dhe bashkëpunimin me Inspektoratin e Komunës së Prishtinës.

Subjekt i këtij auditimi është Ndërmarrja Publike Lokale Prishtina Parking me departamentet përgjegjëse dhe Komuna e Prishtinës me Drejtorinë e Inspektoratit.

Ndërmarrja Prishtina Parking dhe Inspektorati i Komunës së Prishtinës nuk janë treguar efikas dhe efektiv në menaxhimin dhe monitorimin e zbatimit të rregullorës për një organizim të mirëfilltë të parkingjeve publike. Ndërmarrja Prishtina Parking është ende në konsolidim, përcjellët me ndryshime rregullative, kontrollet janë të dobëta dhe ka raste që nuk janë në gjendje të dëshmojnë aktivitetet e tyre.

Menaxhimi i parkingjeve publike dhe lejeve të parkimit është karakterizuar me mangësi të theksuara. Një numër i konsiderueshëm i lejeve të parkimit janë lëshuar pa dokumentacionin e nevojshëm. Ndërmarrja nuk kishte arritur të bëjë një planifikim të duhur të parkingjeve duke mos priorizuar mjaftueshëm parkimin për banorët rezidentë kundrejt përdoruesve biznesor. Kjo kishte shkaktuar probleme në disponueshmërinë e vendeve të parkimit. Për më tepër kishte mungesë të transparencës dhe besueshmërisë nga procedurat jo të rregullta të cilat kanë dëmtuar reputacionin e Ndërmarrjes tek qytetarët. Dështimi në zbatimin rigoroz të rregullores dhe aplikimi i standardeve të ndryshme për lëshimin e lejeve në mënyrë jo të përgjegjshme kanë krijuar hapësirë të mundshme për keqpërdorime dhe përfitime të paligjshme.

Mungesa e dokumentimit lidhur me anulimet dhe modifikimet e gjobave dhe dobësitë nga mos arkëtimi i mjeteve nga gjobat e anuluar. Anulimet dhe rivendosjet e gjobave nuk evidentohen në sistemin e brendshëm të ndërmarrjes, duke krijuar hapësirë për keqpërdorime potenciale dhe mungesë transparence. Disa përdorues të sistemit, kanë mundësinë për të bërë anulime dhe ndryshime në gjoba pa mbetur gjurmë dhe pa një vendim të formalizuar nga Ndërmarrja. Zyrtarët përdorin forma joformale për të kërkuar dhe kryer anulime të gjobave, duke rritur mundësinë për përfitime dhe mungesë dokumentacioni të duhur. Një numër jo i vogël i gjobave të shqiptuara anulohen dhe nuk arkëtohen mjetet nga këto gjoba si rezultat i përfundimit të orarit të punës të Ndërmarrjes. Mungesa e dokumentimit për anulimet dhe modifikimet e gjobave krijon hapësirë për keqpërdorime dhe mungesë transparence. Gjobat e anuluar nga të cilat nuk arkëtohen mjete, shkaktojnë humbje të ardhurave për Ndërmarrjen.

Ndërmarrja nuk ka arritur të realizojë digjitalizimin e sistemit të parkingjeve me laura dhe shenjëzimin e parkingjeve. Mungesa e një plani të detajuar dhe afateve kohore konkrete ka bërë që të mos funksionalizohet sistemi digjital i menaxhimit të parkingjeve me laura. Funksionimi manual i laurave dhe monitorët jashtë funksionit kanë shkaktuar konfuzion dhe kanë ulur efikasitetin operacional, duke ndikuar negativisht në të ardhurat dhe besimin e qytetarëve. Kryesisht në parkingjet e hapura ka një mungesë të planifikimit dhe monitorimit të strukturës kontrolluese të Ndërmarrjes duke ndikuar në një mbikëqyrje joefektive të kontrollorëve për kontrollet dhe inspektimet nga dispeçerët. Ndërmarrja Prishtina Parking operon pa një plan të strukturuar për shenjëzimin e parkingjeve në qytet, duke vepruar në mënyrë ad-hoc. Mangësitë në shenjëzimin horizontal e kanë vështirësuar orientimin dhe parkimin e lehtë dhe të rregullt për drejtuesit e automjeteve

Proceset e dobëta të kontrollit të brendshëm dhe financiar po dëmtojnë menaxhimin e parkingjeve. Kontrollet e brendshme janë joefikase, duke ndikuar negativisht në menaxhimin e parkingjeve. Organizimi i dobët i detyrave dhe përgjegjësive ka çuar në planifikim joadekuat të kontrolleve dhe inspektimeve nga dispeçerët, duke rezultuar në mbikëqyrje joefektive të kontrollorëve në parkingjet e hapura. Mungesa e formularëve zyrtarë për pranim-dorëzim të parasë së gatshme dhe funksionimi manual i sistemeve kanë shkaktuar humbje financiare për ndërmarrjen, duke ulur të ardhurat nga gjobat dhe tarifatat e parkimit. Inspektoratit të Komunës së Prishtinës i mungon një plan i strukturuar për inspektimet dhe mbikëqyrjen e parkingjeve publike, duke u mbështetur kryesisht në ankesat e qytetarëve. Në raste të caktuara Inspektorati ka kryer inspektime mirëpo këto inspektime nuk janë evidentuar dhe janë pa dokumentacion të rregullt për veprimet dhe gjobat e shqiptuara.

Vlen të theksohet se, Prishtina Parking nuk ka arritur të hartoj Rregulloret për organizimin dhe menaxhimin e parkingjeve duke u bazuar në të dhëna dhe analiza të duhura, por kryesisht janë bazuar në ankesat e qytetarëve.

Gjetjet e auditimit tregojnë se çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e parkingjeve publike nga Ndërmarrja Prishtina Parking dhe Inspektorati i Komunës së Prishtinës kërkojnë përmirësim të menjëhershëm dhe për këtë janë dhënë 12 rekomandime. Lista e rekomandimeve është paraqitur në Kapitullin 5 të këtij raporti.

Përgjigjja e entitetit

Ndërmarrja Publike Lokale Prishtina Parking është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit si dhe është zotuar se do t'i zbatojnë rekomandimet e dhëna, Komuna e Prishtinës nuk ka kthyer përgjigje.

THE
R
Y
E

01

1. Hyrje

Parkingjet luajnë rol kyç në jetën e përditshme të banorëve dhe vizitorëve. Disponueshmëria, qasja dhe cilësia e parkingjeve publike ndikojnë ndjeshëm në lëvizjen, komoditetin dhe kënaqësinë/rehatinë e banorëve të një qyteti. Komuna e Prishtinës, si qendër urbane mjaft e ngarkuar, ia ka besuar menaxhimin e parkingjeve publike Ndërmarrjes Publike Lokale “Prishtina Parking” tutje PP, subjekt përgjegjës për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e fluksit të trafikut brenda Komunës së Prishtinës. PP ofron shërbime parkimi, pagesash dhe kontrolli për banorët e qytetit duke synuar që të reduktoj trafikun në qytet, siguroj hapësira të parkimit të organizuara dhe të sigurta për të gjithë qytetarët, dhe të përmirësoj përvojën e parkimit për banorët, bizneset dhe vizitorët e Prishtinës. Gjithashtu përmes mënyrave të shumta dhe të lehta të pagesës, Ndërmarrja synon që të ofroj transparencë të plotë në raport me qytetarët duke synuar që të ofroj zgjidhje të përhershme me qasje të lehtë për parkim⁶.

Megjithatë, me zhvillimin e dinamikës urbane dhe rritjen e kërkesave për objektet e parkimit, efektiviteti i këtij procesi të menaxhimit është vënë në pikëpyetje nga akterë të ndryshëm, duke përfshirë qytetarët dhe palët e tjera relevante.⁷

Komuna e Prishtinës ka hartuar rregulloren për veprimtarinë e PP dhe bënë inspektimin e operimeve në parkingjet publike përmes inspektoratit të saj. PP zhvillon aktivitetet e

përditshme të funksionimit, mirëmbajtjes dhe mbledhjes së të ardhurave nga parkingjet.

Bazuar në Rregulloren për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës⁸ kemi tre lloje të parkingjeve:

1. Vend parkimet publike, me kohë të caktuar që përfshijnë vend parkimet përgjatë rrugëve publike dhe hapësirave të destinuara si vend parkime publike si dhe vend parkimet Parko dhe Udhëto (Park & Ride);
2. Vend parkimet me Partneritet Publiko Privat-PPP – garazhet dhe
3. Parkingjet private.

Kjo rregullore po ashtu klasifikon hapësirat e parkimit në zona, secila me karakteristikat e saj unike, çmimet dhe kufizimet e kohëzgjatjes. Zonat variojnë nga “Qendra e Qytetit” (Zona I), hapësira nga unaza qendër deri tek unaza e brendshme e qytetit (Zona II) dhe hapësirat jashtë unazës së brendshme (Zona III)⁹, duke plotësuar një spektër të gjerë kërkesash parkimi. Banorëve duhet të ju ofrohen hapësira parkimi të dedikuara në zonat e “Kaltërta” dhe “Vjollce” (me parapagim), ndërsa zonat “Portokallta” ofrojnë mundësi parkimi afatshkurtër për të gjithë përdoruesit¹⁰.

6 <https://prishtinaparking.net/rreth-nesh/>.

7 <https://telegafi.com/parkingu-falas-per-veturen-e-pare-kmdlj-vlen-vetem-per-lagjet-periferike-komuna-e-prishtines-nuk-informoi-qtetaret/>; <https://kallxo.com/komuna/banoret-nuk-lejohne-punimet-ne-parking-kryeshefi-i-prishtina-parking-jep-detaje-te-projektit/>.

8 Rregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës 2019;

9 Rregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës 2019 Neni 6.

10 Rregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës 2019 Neni 5.

Në këtë auditim janë trajtuar vend parkimet publike, me kohë të caktuar që përfshijnë vend parkimet përgjatë rrugëve publike dhe hapësirave të destinuara si vend parkime publike.

Figura 1. Zona I (Qendra e Qytetit).



Burimi: Prishtina Parking

PP është e përkushtuar në implementimin e zgjidhjeve inovative për të përmirësuar eksperiencën e parkimit. Në këtë kontekst, një nga hapat veçohet vendosja e parkingjeve “Parko dhe Udhëto”. Këto zona parkimi janë vendosur strategjikisht larg qendrës së qytetit, dhe duhet të lidhen pa probleme me transportin publik. Ky veprim synon reduktimin e mbipopullimit në zonën urbane dhe ofron mundësi parkimi të përballeshme për udhëtarët¹¹.

Tutje, rregulloret e parkimit të Prishtinës kërkojnë që përdoruesit t’u përmbahen kufizimeve specifike kohore, mënyrave të pagesës dhe zonave të caktuara të parkimit bazuar në zonat e koduara me ngjyra. Këto masa synojnë ruajtjen e rendit, qasjes dhe drejtësisë në shfrytëzimin e hapësirave publike të parkimit.

11 Rregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës 2019, Neni 6.1

OBJEKTIVA
E

ADDITIONAL
MIT

02

2. Objektiva dhe pyetjet e auditimit

Objektivë e auditimit është të vlerësojmë efikasitetin dhe efektivitetin e shërbimeve të ofruara nga Prishtina Parking për qytetarët. Po ashtu do të vlerësojmë bashkëpunimin me Inspektoratin e Komunës së Prishtinës.

përkatësisht Departamenti i Inspektoratit. Auditimi ka mbuluar periudhën 2022, 2023 dhe deri në muajin maj të vitit 2024.

Metodologjia e detajuar dhe fushëveprimi i auditimit janë paraqitur në Shtojcën 1.

Pyetjet e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektives së auditimit kemi parashtruar pyetjen kryesore dhe pyetjet e auditimit si në vijim:

Sa është efektive Prishtina Parking në menaxhimin e parkingjeve publike në Komunën e Prishtinës?

1. A ka arritur Prishtina Parking që të bëjë një planifikim të duhur të parkingjeve për të siguruar disponueshmërinë e nevojave për banor rezident dhe për shfrytëzuesit e parkingjeve komerciale?
2. A ka arritur Prishtina Parking të ofroj shërbime të duhura për qytetarët për një qasje dhe shfrytëzim të lehtë, transparent edhe efikas të parkingjeve publike për të gjithë qytetarët?
3. A ka siguruar Prishtina Parking planet, kontrollat dhe bashkëpunimin e duhur për shfrytëzimin e parkingjeve nga rezidentët dhe parkingjet komerciale dhe përcjelljen e tyre?

Fushëveprimi i këtij auditimi është Ndërmarrja Publike Lokale Prishtina Parking duke u fokusuar në: Departamentin e Operimeve, Departamentin e Zhvillimit të Biznesit dhe Departamentin e Teknologjisë Informative. Gjithashtu pjesë e fushëveprimit ishte Komuna e Prishtinës

GREENWICH
UNIVERSITY

03

3. Gjetjet e auditimit

Përgjegjës për sistemin e rregullimit të aktiviteteve të parkimit në Qytetin e Prishtinës është Ndërmarrja Publike Lokale (NPL) Prishtina Parking (PP) dhe Komuna e Prishtinës më konkretisht Drejtoria e Inspektoratit. Ndërmarrja përmes një planifikimi të duhur synon të siguroj vende parkimi për banorët rezident dhe njëkohësisht të menaxhoj parkingjet për bizneset dhe qytetarët e tjerë. NPL PP është përgjegjëse për pajisjen e qytetarëve me leje të parkimit dhe të siguroj që parkingjet publike shfrytëzohen vetëm në pajtim me kriteret.

Departamenti i Operimeve (DO) në kuadër të PP bënë shqyrtimin e aplikacioneve dhe kërkesave të qytetarëve për tu pajisur me leje të parkimit. Për të aplikuar për një leje parkimi, qytetarët duhet të plotësojnë disa kriteret të caktuara përfshirë adresën e banimit (certifikatën e pronësisë) apo kontratën e qerasë, librezën e qarkullimit, dhe të tjera (jo obligative)¹². Po ashtu qytetarët me plotësimin e kriterëve janë të obliguar që të kryejnë pagesën varësisht nga zonat e caktuara bazuar në vendimin për caktimin e çmimores.¹³

Në rast se nuk plotësohen kriteret Ndërmarrja refuzon aplikimin/kërkesën dhe ka kompetencë që më vonë nëse sheh ndonjë kriter i cili nuk është plotësuar të bëjë revokimin e lejes.

Departamenti i Zhvillimit të Biznesit në kuadër të DO është përgjegjës për të hartuar planet lidhur me menaxhimin e parkingjeve me laura dhe shenjëzimin horizontal dhe vertikal të parkingjeve¹⁴. Departamenti i Teknologjisë Informative bënë mirëmbajtjen e sistemit të brendshëm ku janë të evidentuara të gjitha të dhënat e ndërmarrjes përfshirë të dhënat e lejeve të parkimit, gjobat, qasjet dhe autorizimet e zyrtarëve etj.

Drejtoria e Inspektoratit në Komunën e Prishtinës harton planet e kontrollit dhe siguron zbatimin e këtyre planeve. Gjithashtu kontrollon përdorimin e duhur të parkingjeve publike dhe private, urdhëron korrigjimin e mangësive, shqipton dënime mandatore dhe ndërmerr masa të tjera për respektimin e rregullores.

Gjetjet e auditimit tregojnë për një proces që karakterizohet me ngecje të cilat lidhen direkt me lëshimin e lejeve të parkimit nga Ndërmarrja/PP. Papërgjegjësitë e Ndërmarrjes në lidhje me zbatimin e kriterëve ku qytetarët janë pajisur me leje parkimi nëpër zona të caktuara pa plotësuar kriterin e banorit rezident në atë zonë. Po ashtu pa plotësimin e kriterëve të tjera sikurse është kriteri i posedimit të veturës apo i autorizimit të saj apo dhe të tjera. Përcjellja e aktiviteteve të kontrollorëve nga mbikëqyrësit e tyre në Ndërmarrje, nuk evidentohet dhe kjo tregon për një proces mbikëqyrës të mangët. Gjobat e shqiptuara

12 Rregullore për parkingjet e banoreve rezident ne 2021, neni 4 (dokumentet shtesë, nëse automjeti nuk është në pronësi të banorit rezident, kërkohet autorizimi kopje, certifikata e bashkësie familjare se personit nëse vendbanimi është në emër të prindërve ose gjyshërve.

13 Vendim për miratimin e çmimores për Parkingjet publike të Komunës së Prishtinës

14 Udhëzim mbi Përshkrimin e Detyrave të Punës për Departamente dhe Zyra - 2020

anulohen dhe rishkruhen pa një evidentim të duhur. Disa nga gjobat e anuluar nuk evidentohen fare. Në përfundimin e orarit të punës së Ndërmarrjes, bllokadat e vendosura dhe gjobat e shqiptuara anulohen. Shenjëzimi si parakusht për të operuar ndërmarrja nuk realizohet në mënyrën e duhur dhe karakterizohet me planifikime ad-hoc.

Po ashtu kontrollet e Inspektoratit Komunal nuk janë të planifikuara në baza të rregullta mirëpo janë të orientuara kryesisht në anketat e qytetarëve dhe ato ad-hoc.

Më poshtë janë paraqitur gjetjet të cilat janë rezultat i analizimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, auditimit të proceseve, testimeve, ekzaminimeve si dhe intervistave me zyrtarë përgjegjës në terren. Dëshmitë e mbledhura kanë shërbyer në dhënien e konkluzioneve të cilat janë paraqitur në Kapitullin 4 dhe rekomandimeve për përmirësimin e proceseve që janë paraqitur në Kapitullin 5.

3.1. Planifikimi dhe lëshimi i lejeve të parkimit nga Prishtina Parking janë jo efektive

Qytetarët për tu pajisur me lej parkimi, aplikojnë në Ndërmarrje duke sjellur dokumentacionin i cili kërkohet sipas rregullores. Përmes aplikacionit lidhin një kontratë me Ndërmarrjen për të marrë shërbimet e parkimit. Në kontratë janë të cekura të dhënat e veturës përfshirë targat, emri dhe mbiemri i qytetarit dhe informata të tjera. Departamenti i Operimit bënë vlerësimin e dokumentacionit dhe nëse plotësohen kriteret përfshirë edhe pagesat, lëshon lejen mujore apo vjetore të parkimit.

3.1.1. Ndërmarrja ka lëshuar leje parkimi për qytetarët të cilët nuk kanë plotësuar kriteret e banorit rezident

Ndërmarrja duhet të ofroj shërbime cilësorë parkimi për banorët rezident dhe me çmime të përshtatshme, përmes pagesës.¹⁵ Banorë rezident janë ata banor të cilët jetojnë në rrugën ku parkimi paguhet¹⁶. Gjithashtu duhet të siguroj që vetëm banorët që plotësojnë kriteret në vazhdim mund të pajisen me leje parkimi në zonën ku banojnë apo bëjnë kërkesë për të ushtruar veprimtarinë e tyre biznesore etj.

15 Rregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës.

16 Raporti Vjetor i Prishtina Parking për vitin 2022. f.q 18. Rregullore neni 4. Pika 7.1.

Opsionet e abonimit për lejet e parkimit publik, duke përfshirë ditore, javore, mujore dhe vjetore, duhet të komunikohen qartë përdoruesve. Në rregulloren për organizim të brendshëm parashihet çmimorja dhe kriteret për shfrytëzuesit e parkingjeve publike, si në vijim:

Kriteret për tu pajisur me leje parkimi për banorët rezident

Aplikacionin;

Certifikata e Pronësisë (tatimi në pronë)

Kontrata e qerases e noterizuar (kopje)

Libreza e Qarkullimit të veturës (kopje)

Patentë Shoferi dhe letërnjoftimi (kopje)

Dokumente shtesë sipas nevojës (jo obligative)

Çmimorja e parkingut për banorët rezident (vetura 1)

Zona I: 10 euro/muaj, 100euro/viti

Zona II: 7 (shtatë) euro/muaj, 70 euro/viti

Zona III : 5 (pesë) euro/muaj, 50 euro/viti

Çmimorja e parkingut për banorët rezident (vetura 2)

Zona I: 30 euro/muaji, 300 euro/viti

Zona II: 15 euro/muaji, 150 euro/viti

Zona III: 10 euro/muaji, 100 euro/viti

Sipas rregullores së vitit 2024 më konkretisht çmimores¹⁷, banorët rezident mund të pajisen me leje parkimi për veturën e parë, vetëm me pagesë të tarifës prej 10 euro në vit për mbulimin e shpenzimeve administrative të Ndërmarrjes. Nga fillimi i vitit 2024, Ndërmarrja operon sipas rregullores së re duke kërkuar nga banorët që të fillojnë regjistrimin që të lirohen nga pagesa e veturës së parë dhe më pastaj të vazhdojnë me regjistrimin apo edhe me revokimin e licencave për banorët jo të rregullt/fiktiv të regjistruar apo ata të cilët nuk kanë plotësuar kriteret për tu pajisur me leje parkimi. Ky proces është i vazhdueshëm dhe nuk kemi ngritur ndonjë çështje për këtë periudhë.

Ndërsa për vitet 2022 dhe 2023 kemi vërejtur se Ndërmarrja ka mangësi në aktivitetet e saja si dhe nuk ka caktuar prioritete të parkingjeve për banorët rezident në krahasim me bizneset apo me qytetarët që shfrytëzojnë parkingjet për nevoja komerciale. Për këtë periudhë janë lëshuar rreth 13,493 leje për banor rezident.

Kemi analizuar 199 vendime/mostra të lejeve të parkimit të lëshuara dhe të menaxhuara nga Ndërmarrja kryesisht për shfrytëzimin e parkingjeve të hapura nga qytetarët. Mostrat janë kryesisht për Zonën I (zona qendër) dhe Zonën II (Lagja Bregu i Diellit, Dardania dhe Ulpiana) të Qytetit të Prishtinës. Lejet e parkimit me fokus janë marrë/analizuar në Zonën I për shkak se kërkesa në këtë zonë është më e lartë

17 Rregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës 2024, aneks 1, 1.2.2.

për tu pajisur me leje parkimi. Ndërmarrja ka lëshuar leje parkimi për banorët që nga viti 2022 përmes zyrës së “Tavolinës Ndhmëse”¹⁸ në kuadër të Ndërmarrjes.

Nga 199 mostrat e lejeve të parkimit të analizuara kemi gjetur se 108 apo rreth 54% e mostrës janë lëshuar pa plotësimin e kriterëve bazike. Parregullsitë nga këto mostra kryesisht i takojnë parkingjeve në Zonën I.

- 87 leje apo rreth 43% nga totali i mostrave janë lëshuar nga Ndërmarrja (Tavolina Ndhmëse) pa plotësimin e kriterëve të caktuar në rregullore, si dhe
- 21 janë leje të parkimit të lëshuara nga Ndërmarrja për të cilat nuk është respektuar kriteri i veturës së dytë për qytetarin¹⁹.

Për 30 mostra tjera, Ndërmarrja nuk posedon fare dokumentacionin e nevojshëm për leje të parkimit. Këto leje parkimi janë paguar dhe janë të regjistruara në ueb-aplikacionin të cilin e përdor Ndërmarrja si databazë e të dhënave të banorëve, mirëpo pa dokumentacion mbështetës. Këto dokumente nuk ka arritur t’i siguroj Ndërmarrja duke pohuar se nuk disponojnë dokumentacionin e tillë. Bazuar në këtë, Ndërmarrja ka lejuar automjete apo persona të paautorizuara të përdorin parkimin publik duke mbingarkuar/zënë parkingjet për qytetarët e rregullt/rezident.

Për më tepër nga Ndërmarrja, qytetarët janë pajisur me leje parkimi në zonat të cilat nuk janë banor të zonës përkatëse duke sjellur vetëm librezën e qarkullimit të veturës apo vetëm me letërnjoftim.

Në vazhdim për elaborim të gjetjeve të theksuara kemi paraqitur disa mostra/raste në formën tabelare. Rastet/mostrat e tjera gjenden në shtojcën 2 të këtij raporti.

¹⁸ Zyrtarët përgjegjëse të caktuar për lëshimin e lejeve të parkimit.

¹⁹ Vetura e dytë për njësi banesorë, sipas çmimoreve dhe rregullores së Prishtina Parking duhet të paguhet me çmim tjetër. Ndërsa qytetarët kanë paguar me çmime të njëjtë si për veturën e dytë po ashtu edhe për veturën e parë. (Pagesa vjetore për veturën e parë në zonën I është 100 euro ndërsa pagesa për veturën e dytë është 300 euro. Në zonën II pagesa vjetore për veturën e parë është 70 euro ndërsa për veturën e dytë 150 euro).

Tabela 1: Lejet e parkingut pa kritere në zonën Qendër, Rruga Sylejman Vokshi

Targat (shkronjat YY janë përdorur për arsye të privatësisë)	Vetura e dytë	Forma aplikimit	Pagesa	Certifikata e pronësisë (tatimi ne prone)	Deklarate e bashkësisë familjare (opcionale)	Kontrata e qerases (noterizuar)	Libreza e qarkullimit	Patentë shoferi dhe letërnjoftimi
01-160-YY		Po	Po nga 10eu	Po	N/a	N/a	Po	Po
01-434-YY		Po	Po 100	Po	N/a	N/a	Po	Po
01-426-YY		Po	Po 100	Po	Jo	Jo	Po	Po
01-777-YY		Po	Po 100	Jo	Jo	Jo	Po	Po
01-535-YY		Po	Po 10	Po	N/a	N/a	Po	Po
01-257-YY		Po	Po 100	Jo	Jo	Jo	Po	Po
01-320-YY		Po	Po 10eu	Jo	Jo	Jo	Po	Po
01-641-YY		Po	Po 100	Jo	Po	Jo	Jo	Po

Tabela 2: Lejet e parkingut pa dokumentacionin e nevojshëm në zonën Qendër, Rruga Simon Shiroka

Targat (shkronjat YY janë përdorur për arsye të privatësisë)	Vetura e dytë	Forma aplikimit	Pagesa	Certifikata e pronësisë (tatimi ne prone)	Deklarate e bashkësisë familjare (opcionale)	Kontrata e qerases (noterizuar)	Libreza e qarkullimit	Patentë shoferi dhe letërnjoftimi
01-424-YY		Po	10					Pa dokumente
02-370-YY		Po	300					Pa dokumente
01-910-YY		Po	100					Pa dokumente
01-784-YY		Po	100					Pa dokumente
01-333-YY		Po	10					Pa dokumente
01-323-YY		Po	10					Pa dokumente

Tabela 3. Lejet e parkingut që nuk kanë respektuar kriterin e veturës së dytë – 21 raste.

Nr.	Veturat	Targa	Periudha e pagesës	Koment
1	Vetura 1	01-641-YY	17.05.2023-17.05.2024	100 euro pagese
2	Vetura 2	01-662-YY	30.10.2023-30.10.2024	100 euro pagese
3	Vetura 1	DT-262-YY	11.05.2023-11.05.2024	100 euro pagese
4	Vetura 2	YY-311-77	28.08.2023-28.08.2024	100 euro pagese
5	Vetura 1	01-262-YY	20.09.2022-20.09.2023	100 euro pagese
6	Vetura 2	04-268-YY	27.09.2022-27.09.2023	100 euro pagese
7	Vetura 1	01-258-YY	10.05.2023-10.05.2024	100 euro pagese
8	Vetura 2	YYKR838	20.04.2023-20.04.2024	100 euro pagese
9	Vetura 1	01-956-YY	14.09.2023-14.12.2023	21 euro (7euro/muaj)
10	Vetura 2	01-911-YY	14.09.2023-14.12.2023	21 euro (7euro/muaj)
11	Vetura 1	01-980-YY	08.12.2022-08.12.2023	100 euro
12	Vetura 2	01-766-YY	05.12.2022-05.12.2023	300 euro
13	Vetura 3	01-106-YY	05.12.2022-05.12.2023	100 euro
14	Vetura 1	VR-134-YY	16.06.2023-16.07.2023	10 euro
15	Vetura 2	YY302656	07.08.2023-07.09.2023	10 euro
16	Vetura 1	01-638-YY	17.01.2023-17.01.2024	100 euro
17	Vetura 2	01-616-YY	17.01.2023-17.01.2024	100 euro
18	Vetura 3	01-950-YY	17.01.2023-17.01.2024	100 euro
19	Vetura 4	01-811-YY	17.01.2023-17.01.2024	100 euro
20	Vetura 5	01-721-YY	17.01.2023-17.01.2024	100 euro
21	Vetura 6	01-311-YY	17.01.2023-17.01.2024	100 euro

Burimi: Të dhënat e marrura nga Ndërmarrja për pagesat e veturave të analizuar/audituar

Në tabelën lartë janë paraqitur rastet kur banorët rezident kanë paguar me çmimin e veturës së parë edhe për veturën e dytë dhe të tretë duke e dëmtuar financiarisht Ndërmarrjen.

Bazuar në të dhënat tabelare dhënia e lejeve të parkimit është bërë kryesisht pa plotësim të kriterëve. Kjo ka ndodhur në zonën I në qendër të Qytetit ku edhe kërkesa ishte më e lartë për shfrytëzim të parkingjeve në këtë zonë. Kjo ka ndikuar negativisht në organizmin dhe disponueshmërinë e parkingjeve dhe menaxhimin e tyre si pasojë e vendeve të kufizuara.

Tabela 4. Lejet e parkimit të lëshuara për banorët rezident, biznese dhe të tjera në rrugët e caktuara si mostër në Zonën 1 dhe në Zonën 2.

Rruga	Njësitë banesore	Vend parkingjet	Lejet e lëshuara për rezident	Lejet për vetura të dyta	Lejet për Biznese	Të tjera
Sylejman Vokshi (Zona I)	250	165	66	4	20	1
Simon Shiroka (Zona I)	160	121	26	2	2	2
Andrea Gropa (Zona I)	40	60	6	4	/	/
Rexhep Luci (Zona I)	60	13	68	/	/	/
Hajdar Dushi (Zona I)	120	52	52	/	/	1
Imzot Nikë Prela (Zona II)	200	186	195	/	7	/
Henry Dunant (Zona II)	70	63	149	/	4	/
Lekë Dukagjini (Zona II)	300	148	240	/	/	/
Taulantia (Zona II)	90	30	31	2	0	0
Ilir Durmishi (Zona II)	90	53	41	/	/	/

Në tabelën 4 janë paraqitur të dhënat mbi numrin e njësive banesore, vend parkingjeve si dhe lejeve të lëshuara për banorët rezident, për biznese dhe të tjera. Lejet e lëshuara nga Ndërmarrja janë për veturat e para dhe veturat e dyta në krahasim me vend parkingjet në dispozicion, e që në disa raste janë më shumë leje se parkingje në dispozicion.

Ndërsa në rrugët Egnatia, Idriz Gjilani, Nënë Tereza, Sejdi Kryeziu, Pashko Vasa, Perandori Justinian dhe Vëllezërit Gërvalla për shkak të mos plotësimit të parakushteve infrastrukturore dhe shenjzimit Ndërmarrja nuk ka filluar operimin por ka lëshuar leje parkimi për banorët rezident në këto rrugë duke i mundësuar këtyre banorëve që të shfrytëzojnë parkingjet në rrugët tjera afër banesave të tyre. Pavarësisht se Ndërmarrja nuk ka krijuar parakushte për operim ka lëshuar leje parkimi për banorët në këto rrugë. Kjo u ka mundësuar banorëve të përdorin hapësirat e parkimit në rrugët fqinje, e cila potencialisht mund të krijojë mbingarkesë të parkingjeve dhe të ketë pakënaqësi tek banorët.

Ne kemi vlerësuar raportet e ankesave të qytetarëve drejtuar Ndërmarrjes dhe nga këto të dhëna kemi vërejtur që kryesisht ankesat janë të natyrës teknike sikurse janë problemet me operatorin e shërbimit

të telefonisë që lidhen me mos dërgimin e sms-ve, gabimet teknik në shtypjen e numrit të targave, mos kryerja e pagesës me kohë dhe kërkesave tjera të ndryshme por nuk kemi hasur në ankesa të natyrave të tjera që ndërlidhen me disponueshmërinë e vendparkingjeve.

Megjithatë nga lejet e audituara rezulton se më shumë se 50% e lejeve janë lëshuar pa kritere të nevojshme dhe kjo mund të krijoj pakënaqësi tek banorët rezident lidhur me disponueshmërinë dhe mbarëvajtjen e parkingjeve.

Njëkohësisht mund të krijoj pakënaqësi me ofrimin e shërbimeve dhe ulë besueshmërinë e Ndërmarrjes tek banorët rezident të zonave të caktuara, kjo vërehet përmes numrit të lartë të lejeve të lëshuara pa plotësimin e kritereve.

Dhënia e lejeve të parkimit për banorët rezident pa qenë banor i zonës dhe pagesa e veturës së dytë me çmimin e veturës së parë për mostrat e testuara ka shkaktuar dëm financiar. Për 21 mostrat apo 11% e rasteve dëmi financiar është prej 2,815 euro. Përveç se ka ulur të ardhurat e Ndërmarrjes nga tarifat e parkimit, kjo ka krijuar një perceptim negativ për menaxhimin dhe integritetin e shërbimeve të ofruara. Dhënia e lejeve për jo rezidentët, krijon mundësi që ato leje parkimi të huazohen apo të ofrohen me pagesë tek personat e tjerë duke rritur mundësinë për keqpërdorim dhe duke reduktuar dhe më tej parkimin e disponueshëm. Parregullsitë e tilla kanë një ndikim negativ në aspektin ekonomik dhe financiar të Ndërmarrjes, duke lënë hapësirë për keqpërdorime dhe dëmtim të buxhetit të saj. Ndërmarrja ka dështuar të sigurojë zbatimin rigoroz të rregulloreve, duke lejuar dhënien e lejeve të parkimit për qytetarët pa qenë banorë rezident i zonës së caktuar dhe duke aplikuar pagesën e veturës së dytë me çmimin e veturës së parë, që është më i ulët.

Si rezultat, janë kufizuar hapësirat e parkimit dhe reduktuar parkingjet për banorët rezident legjitim nga jo rezidentët. Kjo qon në pakënaqësi për banorët që kanë nevojë të parkohen afër vendbanimit të tyre.

Përkundër faktit që kriteret për lëshimin e lejeve të parkimit ishin mjaftë të qarta dhe specifike sipas rregullores së vitit 2019, menaxhmenti i Ndërmarrjes ka pohuar se deri në maj të vitit 2024 kishin zbatuar standarde të ndryshme të lëshimit të lejeve të parkimit (sikurse ishin autorizimet për veture, etj) duke neglizhuar zbatimin e kritereve të rregullores e cila ishte në fuqi.

Qytetarët që paguajnë në mënyrë të rregullt për lejet e parkimit nuk trajtohen në mënyrë të barabartë dhe kjo mund të rrisë ankesat e tyre ndaj Ndërmarrjes.

Përveç këtyre forma aplikimit/kërkesa që duhet ta plotësojnë qytetarët për t'u pajisur me leje parkimi është forma ku evidentohen të dhënat e targave të veturës data dhe nënshkrimi i qytetarëve. Por përmes kësaj forme të aplikimit nuk është e mundur të vërtetohet nëse janë sjellur me kohë dokumentet e duhura për aplikim. Ekziston rreziku që këto dokumente mund të sjellën edhe më vonë ndërsa pala të pajiset me leje të parkimit edhe pa plotësuar në kohë kriteret.

3.1.2. Anulimi i gjobave nuk evidentohet në sistemin e brendshëm të Ndërmarrjes

Ndërmarrja duhet të shqiptoj gjobë për qytetarët të cilët parkojnë veturat e tyre në parkingjet publike mirëpo nuk respektojnë kriteret e parkimit.²⁰

Gjobat e shqiptuara për shfrytëzimin e parkingjeve nga qytetarët, regjistrohen në ueb aplikacionin e brendshëm të Ndërmarrjes, megjithatë gjobat e anuluar apo të ri shqiptuara mbeten të pa evidentuara në këtë sistem.

Janë analizuar gjobat për vitin 2022, 2023 dhe 2024, mënyra e lëshimit të tyre dhe vendosjes së bllokadave në veturat të cilat shfrytëzojnë parkingjet publike të menaxhuara nga Ndërmarrja ndërsa nuk kryejnë obligimet/pagesat. Nga analiza e të dhënave nga ueb aplikacioni kemi vërejtur se regjistrohen qasjet në sistem²¹ të kontrollorëve të cilët përcjellin shfrytëzimin e parkingjeve nga qytetarët (përmes pajisjeve mobile të cilat i disponon secili kontrollor dhe të cilat janë të lidhur me ueb aplikacionin ku evidentohen të gjitha të dhënat). Çdo qasje në sistem, regjistron kohën, kredencialet dhe të dhënat e tjera të kontrollorëve të cilët bëjnë kontrollin nëse është realizuar pagesa për shfrytëzimin e parkimit. Qytetarit për një periudhë parkimi prej 10 minuat nuk i vendoset gjoba dhe nuk i bllokohet makina. Pas kësaj periudhe, kontrollori printon/shqipton gjobën dhe vendos bllokadën në veturë. Pas realizimit të pagesës për gjobën e shqiptuar kontrollori largon bllokadën dhe lirohet vetura.

Në lidhje me këtë kemi identifikuar se janë disa përdorues (user) në ueb aplikacion që kanë autorizime dhe mund të bëjnë fshirjen e gjobave nga ueb aplikacioni në raste të caktuara. Këta “përdorues” apo autorizime i përdorin zyrtarët e TI-së dhe mbi të gjitha këto fshirje apo anulime apo edhe rivendosje të gjobave bëhen nga zyrtarët e TI-së duke mos lënë gjurmë mbi anulimin, fshirjen e gjobës dhe duke mos ofruar të dhëna apo informata se cilat gjoba janë anuluar.

Nga analizat tona të mëtejme kemi vërejtur se kjo dukuri ndodhë në rastet kur bëhen gabime nga kontrollorët në teren dhe lëshohen gjoba gabim (shembull: bëhen gabime në numra apo në shkronja të targave nga kontrollorët), atëherë kontrollori kërkon nga zyrtarët e TI-së që përmes qasjes që kanë të bëjë eliminimin e gjobës dhe vendosjen e gjobës tjetër. Po ashtu edhe në raste kur bëhet ndonjë gabim tjetër teknik të lejohet anulimi i gjobës. Ky proces (komunikim) i anulimit të gjobës apo vendosjes së gjobës tjetër bëhet përmes formave jo formale (duke shfrytëzuar whatsapp etj, për të njoftuar zyrtarin që ka qasje për anulim) dhe jo përmes mënyrave formale ku mbeten gjurmë të anulimit të gjobave. Në fund të procesit në ueb aplikacion nuk mbetet asnjë gjurmë (historiku) lidhur me këto ndryshime.

Nga zyrtarët e TI-së kemi pranuar si arsyetim se disa prej tyre kanë qasje në sistem për fshirjen dhe anulimin e gjobave e cila ka mbetur nga funksionalizimi i ueb aplikacionit në Ndërmarrje dhe nuk është e rregulluar (me vendim apo autorizim) në mënyrën e duhur nga ndërmarrja. Si rezultat, ka një mungesë të kontroleve të brendshme, mundësi keqpërdorimi nga zyrtarët dhe favorizime duke ndikuar negativisht direkt në cilësinë e jetës së qytetarëve e në veçanti te banorëve rezident.

20 Rregullore për Organizimin dhe Shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës, neni 22 dhe neni 18.

21 Qasjet në sistem/regjistrimet nga kontrollorët.



Bazuar në këtë vlerësojmë se mungon ndërtimi i një sistemi adekuat dhe të sigurtë i cili ofron siguri përmes kontrolleve të brendshme. Njëkohësisht Ndërmarrja nuk ofron trajtim të barabartë të qytetarëve të cilët shfrytëzojnë parkingjet publike.

Për më tepër Ndërmarrja anulon gjobat ndaj qytetarëve të cilët nuk paguajnë deri në orën 23:00, pasi përfundon orari i punës për kontrollerët e Ndërmarrjes. Anulimi i gjobave-biletave 24 orëshe²² rrjedh përmes një vendimi të Ndërmarrjes që parasheh heqjen e bllokadave dhe lirin nga pagesa. Për këtë ndërmarrja është arsyetuar se qytetarët mund të kenë raste urgjence për shfrytëzimin e veturës dhe e kanë të pamundur që ta shfrytëzojnë pasi që bllokada është vendosur nga Ndërmarrja gjatë natës.

Ndërsa Ndërmarrja nuk ka hulumtuar për alternativa apo modalitete efektive në mënyrë që të arkëtoj mjetet nga gjobat/biletat e lëshuara.

Në vazhdim janë paraqitur disa foto të gjobave për ilustrim ku shihet se në disa raste janë parkuar veturat dhe në fund të orarit të punës janë liruar nga pagesa si rezultat i përfundimit të orarit.

Foto 1. Shembujt e qytetarëve të cilët kanë shfrytëzuar parkingjet publike deri në orën 23:00 pa paguar parkimin.



Këto janë disa nga shembuj kur Ndërmarrja ka lëshuar biletën 24 orëshe ndaj qytetarëve të cilët kanë shfrytëzuar parkimin publik mirëpo nuk e kanë paguar shërbimin, ndërsa Ndërmarrja ka anuluar këto bileta dhe i ka liruar veturat nga bllokada si rezultat i përfundimit të orarit në orën 23:00. Përveç këtyre dy rasteve ne kemi gjetur edhe raste të tjera të cilat janë anuluar si rezultat i përfundimit të orarit.

Nga një përlllogaritje të përafërt të biletave 24 orëshe të cilat anulohen si rezultat i përfundimit të orarit në orën 23:00 del se janë afërsisht 15-20 prej tyre në baza ditore. Vlera e një bilete është 20 euro, i bie

²² Këto bileta 24 orëshe më parë në vitin 2022 dhe vitin 2023 janë shqiptuar gjobë dhe emërtimi tyre ka qenë gjobë. Në rregulloren e vitit 2024 këto gjoba janë zëvendësuar me biletë 24 orëshe.

që mjetet e humbura të arrijnë vlerën afërsisht prej 120,000 mijë euro në vit duke ndikuar negativisht në aspektin financiar për Ndërmarrjen.

Si përfundim, Ndërmarrja nuk ka të ndërtuar një sistem të duhur për menaxhimin e operacioneve ditore lidhur me menaxhimin e parkingjeve. Mungon ndërtimi i një sistemi të rregullt i cili krijon siguri përmes kontrolleve të brendshme. Kontrollat e brendshme nuk janë vendosur si duhet dhe jo funksionale duke lënë hapësirë për keqpërdorim. Zyrtarët nga departamenti i TI-së bëjnë anulimin apo edhe ndërrimin e gjobave pa vendime dhe pa lënë gjurmë/histori rreth aktiviteteve të tyre. Janë krijuar mënyra jo formale dhe jo të duhura për përcjelljen dhe shqiptimin e gjobave ndaj qytetarëve të cilat nuk kanë paguar parkingun.

3.1.3. Parkingjet me laura karakterizohen me mungesë të digjitalizimit

Sipas Planit të Biznesit, për vitin 2023 është planifikuar digjitalizimi i sistemit të NPL PP përfshirë parkingjet e mbyllura/me laura. Parkimi me Laura nënkupton shfrytëzimin e parkimit nëpër hapësirat publike të alokuara nga Komuna e Prishtinës për parkime me pagesë. Abonimi mund të bëhet ditore, javor, mujor, vjetor si dhe pagesë për orë të shfrytëzimit.²³

Spektori i Parkingjeve me Laura në kuadër të Departamentit të Zhvillimit të Biznesit ka operuar me dhjetë parkingje në Prishtinë gjatë vitit 2023, ndërsa tri prej tyre janë joaktive në vitin 2024.²⁴ Parkingjet funksionojnë me pagesa manuale përmes inkasantëve nëpër parkingjet me Laura, që organizohen përmes rotacioneve.

Digjitalizimi i Parkingjeve me Laura – Kemi analizuar mënyrën e funksionimit/operimit të laurave dhe deri në çfarë niveli është një laurë e digjitalizuar. Gjithashtu kemi realizuar edhe vizita në terren për të vlerësuar nga afër mënyrën e funksionimit të një laurë. Vizitat janë realizuar në fund të muajit Janar të vitit 2024 dhe gjatë periudhës audituese prill 2024. Kemi vërejtur se monitorët të cilët janë të vendosur përpara laurës i cili duhet të jetë i ndërlidhur me sistemin e laurave dhe të tregoj saktë numrin për parkingjet e lira brenda laurës, këta monitor janë jashtë funksionit apo edhe nuk tregojnë saktë parkingjet e lira. Këto parregullsi i kemi identifikuar në parkingun “Andrea Gropa”, “Rinia” dhe “Ish Flamurtari” dhe janë paraqitur fotot më poshtë.

Edhe përkundër identifikimit të këtyre problematikave nga menaxheret dhe mbikëqyrësit e laurave po ashtu edhe nga vizitat në kohën e auditimit kemi vërejtur që këto çështje nuk janë adresuar. Në vitin 2024 parkingun në rrugën “Isa Boletini” ish flamurtari është larguar laura pasi Ndërmarrja ka vlerësuar zbatimin e mënyrës së segmentimit të parkingut duke e shndërruar në parkim të hapur ndërsa në laurat tjera mbeten të pa adresuara çështjet e tilla të digjitalizimit.

²³ Plani i Biznesit 2022 dhe 2023 - *aktiviteti 5.2.*

²⁴ Parkingjet me laura gjenden në rrugët në Rr: Dritan Hoxha (përballë sheshit 21), Rr. Andera Gropa (afër objekti të Qeverisë), Rr. Shkupi, Rr. Isa Boletini (parkingu ish Flamurtari), Rr. Isa Boletini (te Korrizi), Rr. Luan Haradinaj, Rr. Rinia, Parku Germia, Rr. Sylejman Vokshi, Rr. Vëllezërit Gërvalla (jo aktive), Kino Rina (jo aktive) dhe Rr. Hyzri Talla (jo aktive nga dt. 07.03.2023) duke synuar funksionimin me pagesë si në parkingjet e hapura.

Ndërmarrja në Planin e Biznesit për vitin 2023 kishte paraparë digjitalizimin e sistemit përfshirë edhe parkingjet me laura edhe pse ky plan nuk ishte mjaftueshëm i detajuar (përfshirë kostot dhe afatet kohore për realizimin e aktiviteteve), megjithatë deri në mars të viti 2024, ky projekt nuk është realizuar. Për më tepër për realizimin e Planit të Biznesit apo edhe komponentës së digjitalizimit sikurse në planin e vitit 2022 e po ashtu edhe për vitin 2023 nuk kishte një plan veprimi për realizimin e këtyre aktiviteteve.

Kemi diskutuar me udhëheqësin e Departamentit për Zhvillim të Biznesit dhe me Kryeshefin lidhur me këto çështje. Nga bisedat dhe nga dëshmitë që i kemi pranuar sikurse është një planifikim buxhetor i brendshëm në formë Excel, kemi vërejtur se është bërë një planifikim i shpenzimeve për aktivitetet e digjitalizimit, mirëpo ky planifikim nuk është i detajuar për cilat aktivitete të digjitalizimit do të adresohet dhe madje nuk ka një përshkrim të hollësishëm nëse do të adresoj digjitalizimin specifikisht. Edhe përkundër kësaj Ndërmarrja nuk ka ndërmarr asnjë hap konkret apo ndonjë iniciativë për të adresuar këtë çështje me rëndësi.

Në vazhdim kemi paraqitur disa foto të ekzaminimeve në terren nga ekipi auditues.


Foto 2. Foto të realizuara nga ekipi auditues gjatë vizitave në terren.



Foto: Të realizuara gjatë ekzekutimit të auditimit me datë 19 prill 2024 nga ekipi auditues.



Foto: Të realizuara gjatë periudhës së parastudimit me datë 29 janar 2024.



Në fotot lartë, vërehen monitorët tregues afër laurave të cilët janë jashtë funksionit apo të cilët nuk tregojnë saktë numrin e parkingjeve të lira brenda parkimit publik me laurë në rrugën “Andrea Gropa”, në rrugën “Luan Haradinaj” dhe “Ish Flamurtari” në Prishtinë.

Në parkingun në rrugën “Andrea Gropa” edhe pse monitori tregon që nuk ka vende të lirë brenda laurës, kemi gjetur se janë disa vende të lira. Gjithashtu në foto tek parkingu “Ish Flamurtari” shihen qartë monitorët jashtë funksionit në periudhën kur ky parking ishte funksional përmes laurës.

Mungesa e digjitalizimit të plotë të parkingjeve me laura ka sjellë probleme operacionale dhe ka ndikuar negativisht në efikasitetin dhe funksionalitetin e tyre. Pagesat manuale përmes inkasantëve dhe monitorët jashtë funksionit në disa parkingje kanë shkaktuar konfuzion dhe mosfunksionim të saktë

të sistemit të parkingut, duke ulur besimin e qytetarëve dhe reputacionin e ndërmarrjes. Funksionimi manual i laurave mundëson që inkasantët të hapin laurën pa u evidentuar në sistem dhe kjo mundëson në mënyrë të drejtpërdrejtë keqpërdorimin.

Ndërmarrja ka dështuar në zbatimin e Planit të Biznesit për vitin 2023, i cili është hartuar pa detaje të mjaftueshme për kostot dhe afatet kohore për aktivitete të rëndësishme si digjitalizimi i parkingjeve me laura. Mungesa e një plani veprimi të qartë dhe e detajuar ka rezultuar në mungesë të përparimit dhe zbatimit të plotë të këtij sektori duke shkaktuar tollovi në parkingjet, pamundësuar parkimin në rastet kur ka parkingje të lira dhe rrjedhimisht mos inkasim të mjeteve nga Ndërmarrja.

3.2. Mungon shenjëzimi i zonave të caktuara në Kryeqytet

*Drejtoria e Operimeve (DO) në të kaluarën ndërsa me ristrukturim të Ndërmarrjes tash pjesë e kësaj Drejtorie është Drejtoria e Zhvillimit të Biznesit e cila është përgjegjëse për hartimin e planeve për shenjëzimin vertikal dhe horizontal të parkingjeve në mënyrë që të siguroj kushte për operim dhe të ofroj kushte për parkim në mënyrë të duhur për qytetarët. Planet e Parkimit duhet të jenë të detajuara ku janë paraqitur rrugët të cilat janë nën menaxhimin e ndërmarrjes dhe të cilat janë shënjuar dhe duhet të shënohen përgjatë vitit. Duhet të ketë Plane dhe raporte rreth shenjëzimit të rrugëve/parkingjeve për vitin 2022 dhe për vitin 2023.*²⁵

Janë analizuar raportet dhe planifikimi për shenjëzimin e parkingjeve nga Drejtoritë përkatëse, duke përfshirë intervistat me udhëheqësit e Departamenteve të Operimit dhe të Zhvillimit të Biznesit, dhe menaxherin e kontratës. Janë ekzaminuar fizikisht zona të caktuara, duke përfshirë Lagjen Dardania në zonën 2 dhe rrugët “Sylejman Vokshi” dhe “Fehmi Agani” në zonën 1, ku u identifikuan mangësi në shenjëzim. Në disa raste, si në rrugën “Mark Dizdari” në zonën 2, shenjëzimi ishte i pranueshëm.

PP nuk ka një planifikim të mirë për shenjëzimin e parkingjeve, duke vepruar në baza ad-hoc. Parakushtet tjera për ofrimin e shërbimeve të parkimit për qytetarët, sikurse janë njoftimet mbi shërbimet, mënyrat e pagesës përmes pikave të shitjes dhe SMS-ve, dhe një aplikacion për pagesa online janë funksionale. Në shumicën e zonave të parkimit janë vendosur tabela vertikale me këto informacione. Megjithatë, janë identifikuar mangësi në shenjëzimet horizontale dhe në parkingjet e mbyllura apo ato me laura. Problemet kryesore të identifikuara janë listuar më poshtë:

Analiza e raporteve javore, mujore dhe të përgjithshme të parkingjeve me laura ka evidentuar problematika teknike, përfshirë probleme me kamerat dhe mosfunksionimin e aparatit për shtypjen e biletave. Këto çështje ndikojnë në efikasitetin dhe funksionalitetin e shërbimit të parkimit.

Mungesa e shenjëzimit horizontal: Në disa rrugë dhe zona, si rruga “Mustafa Venhari” dhe “Sylejman Vokshi”, nuk ka fare shenjëzim horizontal, duke e bërë të vështirë për drejtuesit e automjeteve të orientohen dhe të parkohen në mënyrë të rregullt.




25 Rregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës, neni 7 dhe 8.

Shenjëzimi i padukshëm: Në rrugën “Fehmi Agani”, shenjëzimi ekzistues është i padukshëm dhe nuk është në nivelin e duhur, çka rrit mundësinë e aksidenteve dhe e bën më të vështirë menaxhimin e trafikut.

Andaj qytetarët paguajnë për lejet e parkimit dhe shfrytëzimin e parkingjeve komerciale, por shërbimet e ofruara nuk janë në nivelin e pritshëm, duke mos përmbushur kërkesat minimale për organizimin dhe menaxhimin e duhur të parkingjeve.

Për të ilustruar gjetjet e evidentuara më lartë kemi paraqitur disa foto të ekzaminimeve fizike.

Foto 3. Rruga Sylejman Vokshi dhe Rruga Ahmet Krasniqi të realizuar nga ekipi auditues nga ekzaminimi në terren lidhur me shenjëzimin.





Në vazhdim lidhur me shenjëzimin ne kemi identifikuar raste kur qytetarët janë gjobitur edhe përkundër mungesës së shenjëzimit. Në këtë rast banorët rezident kanë drejtuar ankesat e tyre drejt Inspektoratit të Komunës së Prishtinës, duke shprehur pakënaqësitë e tyre lidhur me mungesën e shenjëzimit. Ndërmarrja nuk ka të drejtë që të shqiptoj gjoba dhe ndëshkime ndaj banorëve në rastet kur nuk ka bërë shenjëzimin. Në këtë rast ndërmarrja është ndëshkuar nga Inspektorati Komunal për mos plotësimin e kushteve për të ushtruar veprimtarinë e saj sikurse është shenjëzimi.

Ndërmarrja ka pranuar se nuk ka bërë përpjekje të mjaftueshme për të organizuar punën e shenjëzimit të parkimit në mënyrën e duhur dhe me kohë përmes planeve.

Për pasojë, Ndërmarrja përgjegjëse për menaxhimin e parkingjeve publike në kryeqytet ka dështuar të zbatojë në mënyrë adekuate kriterin e shenjëzimit, veçanërisht atë horizontal, duke mos përmbushur rregulloren përkatëse. Kjo mungesë e përpjekjeve dhe planifikimit të mirëfilltë ka rezultuar në një menaxhim të dobët të parkingjeve, ku qytetarët janë gjobitur padrejtësisht përkundër mungesës së

shenjëzimit të duhur. Vendimet janë marrë në mënyrë ad-hoc dhe nuk janë bërë përpjekje të mjaftueshme për të organizuar punën e shenjëzimit në mënyrë të duhur dhe me kohë.

Mungesa e shenjëzimit ka çuar në një parkim të paorganizuar, duke e bërë të vështirë për qytetarët të identifikojnë hapësirat e parkimit dhe të respektojnë rregullat e vendosura. Qytetarët mund të ndihen të pakënaqur, pasi paguajnë për shërbime të parkimit që nuk përmbushen si duhet. Kjo pakënaqësi është rritur me gjobitjen e padrejtë të qytetarëve edhe në mungesë shenjëzimi në disa raste. Besimi i qytetarëve në ndërmarrjen dhe menaxhimin e saj është dëmtuar, duke krijuar një perceptim negativ për efikasitetin dhe ndershmërinë e shërbimeve publike. Inspektorati Komunal ka ndëshkuar ndërmarrjen për mosplotësimin e kushteve për ushtrimin e veprimtarisë së saj, duke ndikuar negativisht në reputacionin dhe operacionet e ndërmarrjes.

3.3. Mbikëqyrja e kontrollorëve nga Dispeçeret përcjellët me mangësi dhe nuk evidentohet

Departamentet dhe zyra për monitorimin e kontrolleve më konkretisht dispeçeret duhet të monitorojnë në baza ditore kontrollorët në terren, të bëjnë verifikimin e kontrolleve në raport me pagesat, raportimin për kontrollet e kryera tek mbikëqyrësi.²⁶

Departamenti i Operimeve i përfshin Dispeçeret dhe Kontrollorët të cilët janë përgjegjës për menaxhimin dhe kontrollin e parkingjeve. Dispeçeret monitorojnë punën e Kontrollorëve, ndërsa kontrollorët janë përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të parkimit dhe kontrollin e veturave për pagesën e parkimit në terren. Gjatë vitit 2022, numri i përgjithshëm i punonjësve në Ndërmarrje ishte 194, në parkingjet e hapura 51 punonjës në pozitën Kontrollor. Në vitin 2023, numri i përgjithshëm i punonjësve ka qenë 215, në parkingjet e hapura 59 punonjës në pozitën Kontrollor/Blokues dhe në vitin 2024, përfshirë muajin Prill, janë 200 punonjës në Ndërmarrje, 59 punonjës në pozitën Kontrollor.

Megjithatë, ka mungesë të një plani të strukturuar për organizimin e punës së kontrollorëve. Planet janë të pazhvilluara dhe komunikohen kryesisht përmes formës excel dhe përmes telefonit pa një mënyrë të formalizuar. Nuk ka raporte ditore ose forma tjera që evidentojnë organizimin e punës së kontrollorëve.

Kemi pranuar disa forma të caktimit të detyrave mirëpo pa një plan dhe raport formal. Kemi vërejtur po ashtu se Dispeçeret nuk kanë të evidentuar mënyrën e kontrollimit dhe mbikëqyrjes së kontrollorëve dhe është e pamundur që të përcjellët mënyra e monitorimit të kontrollorëve. Sipas zyrtarëve dispeçeret kryejnë kontrollat monitoruese mirëpo nuk kanë të evidentuar në raporte e për më tepër këto kontrollat nuk evidentohen as në programin e brendshëm të ndërmarrjes. Kjo pasi që nuk ka një mënyrë të mirëfilltë të organizimit të brendshëm dhe një rregullore apo procedura të qarta të operimit.

Kemi vlerësuar gjithashtu punën e kontrollorëve e cilat kryesisht realizohet përmes pajisjeve mobile të cilat i përdorin në terren. Këto pajisje janë të lidhura me bazën e të dhënave programin/aplikacionin

26 Udhëzimi për rregullimin e punëve të departamenteve dhe zyrtarëve, shtator 2023.

e brendshëm të Ndërmarrjes. Në këtë program janë të regjistruara të dhënat e lejeve të parkimit dhe informata të tjera të veturave që shfrytëzojnë parkingjet e PP. Përmes pajisjeve mobile kontrolloret qasen në këto të dhëna dhe sigurohen nëse është bërë pagesa e parkimit. Çdo qasje e kontrollorëve në program regjistrohet dhe është lehtë për tu përcjellur nga mbikëqyrësit/dispeçerët. Megjithatë mbikëqyrja nga dispeçerët nuk evidentohet dhe kjo e bënë të pamundur përcjelljen e dispeçerëve nga mbikëqyrësi Drejtori i Operimit.

Ndërmarrja ka pranuar se ka mungesë të një organizimi më sistematik dhe mungesë të hartimit të planeve të mirëfillta për monitorim dhe kontrolle.

Sipas menaxhmentit të Ndërmarrjes kjo është forma të cilën e kanë përdorur deri në këtë fazë. Megjithatë ne vlerësojmë që kjo formë duhet të përmirësohet dhe të evidentohen në baza ditore mangësitë/dobësitë dhe arritjet e kontrollit të parkingjeve.

Mungesa e evidentimit të monitorimit nga dispeçerët e bën të paqartë se si realizohen kontrollet ndaj kontrollorëve dhe sa efektive është procesi i mbikëqyrjes. Kjo ulë ndjeshëm cilësinë e kontrolleve të kryera në terren. Pa një sistem të mirëfilltë monitorimi dhe raportimi, krijohen mundësi për kontrollorët që të mos kryejnë kontrolle të rregullta dhe të lënë hapësirë për keqpërdorim në procesin e kontrolleve, duke ndikuar negativisht në efikasitetin dhe besueshmërinë e shërbimeve të parkimit. Pa raporte të qarta dhe të dokumentuara, është e vështirë të sigurohet transparenca në operimet e përditshme, gjë që mund të ulë besimin e qytetarëve në ndërmarrje dhe të rrisë pakënaqësinë e tyre ndaj shërbimeve të ofruara.

Po ashtu, mungesa e një sistemi të formalizuar të monitorimit dhe raportimit pengon identifikimin e mangësive dhe dobësive në proceset ekzistuese, duke bërë të vështirë përmirësimin dhe optimizmin e tyre.

Ndërmarrja, përkatësisht Departamenti i Operimeve, nuk ka zbatuar udhëzimin për organizimin e duhur të detyrave dhe përgjegjësive të dispeçerëve në raport me monitorimin e kontrollorëve. Mungesa e një plani formal dhe të dokumentuar të organizimit të punës ka rezultuar në një menaxhim joefektiv të proceseve të kontrollit dhe mbikëqyrjes. Përkundër përdorimit të pajisjeve mobile dhe ueb-aplikacionit të brendshëm për regjistrimin e kontrolleve, nuk ka raporte ditore ose forma të tjera të evidentimit të punës së kryer nga dispeçerët dhe kontrollorët, duke bërë të pamundur monitorimin dhe vlerësimin e saktë të efektivitetit të tyre.

3.3.1. Inspektimet joefektive nga Inspektorati i Komunës së Prishtinës

Inspektorati duhet të hartoj planet e kontrollit dhe të siguroj zbatimin e këtyre planeve. Inspektorati ka autoritet të urdhërojë largimin e menjëhershëm të automjetit të parkuar në kundërshtim me rregulloren. Nëse përdoruesi nuk është i pranishëm ose refuzon, inspektori mund të vendosë për largimin ose konfiskimin e automjetit. Vendimi vendoset në automjet me datën dhe orën e shënuar, duke u konsideruar i dorëzuar në mënyrë të rregullt. Inspektori gjithashtu kontrollon përdorimin e duhur të parkingjeve publike dhe

private, urdhëron korrigjimin e mangësive, shqipton dënime mandatore dhe ndërmerr masa të tjera për respektimin e rregullores për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës.²⁷

Gjatë periudhës 2022 dhe 2023, Inspektorati kishte kompetencën për të mbikëqyrur zbatimin e rregullores dhe punën e Ndërmarrjes, por këto përgjegjësi nuk janë kryer si duhet, me arsyetimin e mungesës së kapaciteteve. Monitorimi i parkingjeve realizohet në kuadër të Ndërmarrjes nga kontrollorët e saj. Këto aktivitete monitoruese/kontrolluese janë caktuar përmes udhëzimit²⁸ të brendshëm të Ndërmarrjes. Ky zhvillim i aktiviteteve nga Ndërmarrja mund të mos jetë efektiv dhe mund të krijoj paqartësi rreth përgjegjësive dhe roleve të njëjës dhe palës tjetër.

Pavarësisht kryerjes së këtyre aktiviteteve nga kontrolloret e Ndërmarrjes, Inspektorati mbetet ligjërish përgjegjës për monitorimin dhe inspektimin e funksionimit të parkingjeve sipas rregulloreve komunale. Kjo mospërputhje ndërmjet praktikës aktuale dhe kërkesave rregullatore ngre shqetësime në lidhje me efektivitetin, pajtueshmërinë dhe respektimin e procedurave të vendosura.

Për më tepër, në disa raste aktivitetet e Inspektoratit janë kryer në bazë të ankesave të qytetarëve dhe nuk janë të përfshira në planifikimet vjetore të rregullta, për shkak të kapaciteteve të kufizuara të Inspektoratit.

Inspektorati ka gjobitur ndërmarrjen për shkelje të rregullores dhe ka ndërmarrë masa ndaj ndërmarrjes për pakënaqësitë e qytetarëve, si pezullimi i punimeve në disa raste në Rrugën “Vëllezërit Gërvalla” tek parkingu me laurë. Megjithatë, mungesa e raporteve dhe procesverbaleve të dokumentuara për këto veprime, mos evidentimi i ankesave nga qytetarëve, rezulton në mungesë transparence dhe llogaridhënieje.

Inspektorati nuk ka një planifikim të rregullt të inspektimeve dhe mbikëqyr zbatimin e rregullores kryesisht në bazë të ankesave të qytetarëve. Ndërmarrja dhe Komuna e Prishtinës nuk kanë bërë analiza të mjaftueshme dhe të bazuara në të dhëna dhe statistika për hartimin e planeve të aktiviteteve dhe rregulloreve për të siguruar menaxhimin efektiv të parkingjeve publike.

²⁷ Rregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës, neni 21.

²⁸ Udhëzim për përkrahimin e vendeve të punës në PP.

3.3.2. Mos barazimet ditore të të hyrave nga pagesat e shfrytëzimit të parkingjeve me larua

Inkasantët e laurave janë të obliguar që të shkarkojnë dhe barazojnë qarkullimin e ndërrimit me dokument intern dhe ngarkojnë arkën kryesore të Ndërmarrjes²⁹. Në baza ditore inkasantët duhet ti ngarkojnë me para të gatshme (nëse ka) në fillim të orarit dhe në fund të orarit ti shkarkojnë nga paraja e gatshme duke përdorur formular ku evidentohet paraja e gatshme dhe ku duhet të nënshkruhen menaxheri dhe inkasanti.³⁰

Është analizuar procesi i barazimit të qarkullimit ditor të parasë së gatshme në mes të Menaxherit të laurave dhe Inkasantëve. Kemi vërejtur se nuk përdoret asnjë formular pranim-dorëzimi i parasë së gatshme mes këtyre dy niveleve kontrolluese. Paraja e gatshme vetëm numërohet dhe barazohet përmes Z-raportit, pa ndonjë formular zyrtar.

Në rastet kur një numër i caktuar biletash lëshohen gjatë ditës, totali duhet të justifikohet dhe të barazohet me fondet e mbledhura në fund të orarit, megjithatë, ky proces nuk është i dokumentuar dhe rrjedhimisht nuk ka as barazim.

Kur lëshohet një biletë, por automjeti është i përjashtuar nga pagesa (për arsye të tilla si të qenit veturë zyrtare apo arsyetime të tjera), këto raste duhet të dokumentohen dhe justifikohen në raportet dhe barazimet ditore.

Analiza e procesit të barazimit të qarkullimit ditor ka treguar se mungesa e përdorimit të një formulari zyrtar për pranim-dorëzimin e parasë së gatshme mes Menaxherit të laurave dhe Inkasantëve përbën një dobësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit financiar.

Mungesa e formularëve zyrtarë për pranim-dorëzim si dhe procesi joformal i barazimit të parasë së gatshme rrit rrezikun e keqpërdorimit dhe mundësinë për përfitim ose gabime financiare.

Mungesa e dizajnit të kontrolleve të brendshme: Proceset joformale dhe mungesa e dokumentacionit dhe dokumentimit të duhur për barazimin e parasë së gatshme tregojnë një dobësi në sistemin e kontrollit të brendshëm të ndërmarrjes, duke e bërë të vështirë ndjekjen dhe auditimin e saktë të qarkullimit të parasë së gatshme

Besueshmëria dhe transparencja e ulët: Proceset e pa përshkruara mirë dhe pa dokumentacion zyrtar zbehin besueshmërinë dhe transparencën e operacioneve të ndërmarrjes, gjë që mund të ndikojë në reputacionin dhe marrëdhëniet me qytetarët dhe palët e interesuara.

29 Rregullore për arka Ndërmarrja Publike Prishtina Parking, neni 8.

30 Praktikrat nga ndërmarrjet publike (Udhëzim për barazim ditor në zyrat postare të PK SH.A.)

Procesi i barazimit të qarkullimit ditor mes Menaxherit të laurave dhe Inkasantëve ka mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit financiar. Mungesa e përdorimit të formularëve zyrtarë për pranidorezimin e parasë së gatshme dhe laurat qëndrojnë të hapura dhe jashtë funksionit gjatë natës, duke lejuar parkimin pa pagesë dhe mos evidentimit e tij në raportet e barazimeve ditore, përbëjnë dobësi në kontrollin e brendshëm të ndërmarrjes.

3.3.3. Mungesa e analizave gjatë hartimit të rregulloreve

Komuna e Prishtinës si hisedar së bashku me Ndërmarrjen, duhet që bazuar në të dhënat dhe informatat që posedojnë lidhur me parkingjet publike dhe njësitë banorë në Kryeqytet, e po ashtu bazuar edhe në nevojat e qytetarëve të hartojnë rregulloret me qëllim të adresimit të nevojave.³¹ Bazuar në praktikën e mira ekipi auditues ka realizuar vizita në Ndërmarrjen Tirana Parking në Shqipëri ku kemi kuptuar disa çështje me rëndësi të cilat janë adresuar dhe kanë prodhuar efekt pozitiv tek qytetarët. Banorët rezident në Qytetin e Tiranës janë të liruar nga pagesa për të gjitha veturat e tyre në zonat ku banojnë.

Ndërmarrja dhe Komuna e Prishtinës nuk kanë bërë analiza të mjaftueshme dhe të bazuara në të dhëna dhe statistika për hartimin e rregulloreve për menaxhimin e parkingjeve publike. Rregulloret janë hartuar bazuar kryesisht në ankesat e qytetarëve pa një bazë të mjaftueshme të të dhënave, analizave dhe praktikave të mira. Gjatë auditimit kemi kërkuar dokumente, procesverbale etj. lidhur me vendimet se si kanë ardhur deri tek hartimi i Rregullores mirëpo nuk kemi pranuar asnjë dokument.

Mungesa e dëshmive dhe analizave të mjaftueshme nga Ndërmarrja, të cilat bëjnë vlerësimin real të nevojave për hartimin e rregulloreve dhe planifikimin e inspektimeve ka shkaktuar pakënaqësi tek qytetarët dhe një qasje jo mjaft serioze ndaj menaxhimit të parkingjeve publike. Vendimet për lirimin nga pagesa për veturat e para në njësitë banesore dhe pagesat për veturat e dyta janë bërë pa një bazë të fortë të dhënash dhe analizë, duke shkaktuar pakënaqësi.

Sipas praktikave të cekura më lartë në Ndërmarrjen Tirana Parking në Shqipëri banorët rezident në Qytetin e Tiranës janë të liruar nga pagesa për të gjitha veturat e tyre në zonat ku banojnë.

Mënyra e rregullimit dhe zbatimit të lirit nga pagesa të qytetarëve është bërë duke i pajisur qytetarët me kartën e banorit rezident dhe në zonën ku ata banojnë janë të liruar nga pagesa. Po ashtu edhe në parkingjet të cilat janë në prani të njësisë banesore apo në oborret e banesave janë të destinuara vetëm për banorë rezident duke evituar të gjitha parkingjet tjera qofshin ato komerciale dhe ato të qytetarëve që janë për vizitë.

31 Vendim për caktimin e komisionit për hartimin e ndryshim plotësimit të rregullores 01-011/02-187748/10.

KONKLUZIONEN

04

4. Konkluzionet

Ndërmarrja Lokale Publike Prishtina Parking dhe Inspektorati Komunal i Komunës së Prishtinës kanë ndërtuar një sistem për të pajisur qytetarët me leje parkimi dhe për të menaxhuar parkingjet publike megjithatë ky sistem nuk është treguar mjaft efikas dhe efektiv. Ndërmarrja ende nuk është konsoliduar plotësisht, përcjellët me ndryshime rregullative dhe mungon funksionimi i duhur i kontrolleve. Problemet kryesore që e karakterizojnë jo efektivitetin e proceseve në këtë sistem janë si në vijim:

Ndërmarrja ka dështuar që të bërë një planifikim të duhur të parkingjeve publike duke mos i dhënë prioritetet të mjaftueshëm parkimin për banorët rezident kundrejt përdoruesve të parkingjeve komerciale, duke shkaktuar kështu probleme në disponueshmërinë e vendeve të parkimit.

Ndërmarrja ka neglizhuar zbatimin e kriterëve të rregullores duke lëshuar një numër të konsiderueshëm të lejeve të parkimit pa dokumentacionin e nevojshëm mbështetës, duke lejuar qytetarët të përfitojnë leje parkimi në mënyrë jo të drejtë. Mungesa e transparencës, procedurat jo të rregullta dhe mungesa e dokumentacionit kanë zbehur besueshmërinë dhe reputacionin e ndërmarrjes tek qytetarët. Neglizhencat e Ndërmarrjes kanë bërë që dështimi në zbatimin rigoroz të rregullores dhe aplikimi i standardeve të ndryshme për lëshimin e lejeve të krijoj hapësirë për keqpërdorime dhe përfitime të paligjshme duke e i bërë proceset jo efikase dhe jo efektive.

Ndërmarrja nuk ka arritur të ofroj shërbime efikase ndaj qytetarëve duke operuar pa një planifikim të strukturuar dhe të detajuar për shenjëzimin e zonave të caktuara në kryeqytet, duke vepruar në mënyrë ad-hoc dhe pa një qasje sistematike. Ekzistojnë mangësi në shenjëzimin horizontal në rrugë dhe zona të caktuara, duke e bërë të vështirë për drejtuesit e automjeteve të orientohen dhe të parkohen në mënyrë të rregullt.

Ndërmarrja nuk ka arritur të realizojë digjitalizimin e sistemit të parkingjeve me laura, siç ishte planifikuar për vitin 2023, për shkak të mungesës së një plani të detajuar dhe afateve kohore konkrete. Funksionimi manual i laurave dhe monitorët jashtë funksionit kanë shkaktuar paqartësi dhe kanë ulur efikasitetin operacional, duke ndikuar negativisht në të ardhurat e Ndërmarrjes dhe besimin e qytetarëve. Procesi aktual i menaxhimit të gjobave dhe anulimit të tyre nuk është i dokumentuar siç duhet në sistemin e brendshëm, duke krijuar hapësirë për keqpërdorim, mungesë të kontrolleve të brendshme dhe humbje financiare.

Kontrollet e brendshme nuk janë efikase duke ndikuar drejtpërdrejt në menaxhimin jo të duhur të parkingjeve. Si rrjedhojë mungesa e organizimit të duhur të detyrave dhe përgjegjësive ka çuar në mungesë të planifikimit real dhe formal për kontrollet dhe inspektimet nga dispeçerët duke rezultuar në mbikëqyrje joefektive të kontrollorëve.

Inspektorati i Komunës së Prishtinës nuk ka një plan të strukturuar për inspektimet dhe mbikëqyrjen e parkingjeve publike, dhe veprimet janë kryer kryesisht bazuar në ankesat e qytetarëve, me kapacitete të kufizuara dhe pa dokumentacion të rregullt për veprimet dhe gjobat e shqiptuara. Aktivitetet

monitoruese dhe inspektuese të parkingjeve nga Inspektorati dhe nga kontrolloret e Ndërmarrjes janë bërë pa një koordinim dhe në mënyrë jo efektive/efektive.

Anulimet dhe rivendosjet e gjobave nuk evidentohen në sistemin e brendshëm të Ndërmarrjes, si pasojë e mos vendosjes së qartë të autorizimeve, duke krijuar hapësirë për keqpërdorime dhe mungesë transparence. Disa përdorues të sistemit, kryesisht zyrtarët e teknologjisë së informacionit, kanë mundësinë për të bërë anulime dhe ndryshime në gjoba pa mbetur gjurmë dhe pa një vendim të formalizuar nga Ndërmarrja. Zyrtarët përdorin kanale joformale (si whatsapp) për të kërkuar dhe kryer anulime të gjobave, duke rritur mundësinë për devijim dhe mungesë dokumentacionit të duhur.

Dobësi në proceset dhe kontrollin financiar si rezultat i mungesave e formularëve zyrtarë për pranim-dorëzim të parasë së gatshme dhe funksionimi manual i sistemeve të cilat potencialisht mund të qojnë në humbje financiare për Ndërmarrjen.

Ndërmarrja nuk ka hartuar Rregulloret për organizmin dhe menaxhimin e parkingjeve duke u bazuar në analiza, të dhëna dhe statistika të mjaftueshme mirëpo kryesisht duke u bazuar në ankesat e qytetarëve.

REKONSTRUKCIJA

05

5. Rekomandimet

Ndërmarrja Prishtina Parking duhet të rrisë nivelin e menaxhimit të parkingjeve publike dhe të zbatojë një proces të mirëfilltë në menaxhimin e tyre përmes:

1. Krijimit dhe zbatimit të procedurave të qarta dhe të drejta për dhënien e lejeve të parkimit duke forcuar procedurat e kontrollit dhe të kryej auditime të brendshme për të identifikuar dhe adresuar çdo parregullsi në procesin e dhënies së lejeve të parkimit.
2. Krijimit të një bazë të dhënave dhe menaxhimit të dokumentacionit përfshirë edhe lejet e parkimit ku dokumentet e nevojshme të jenë të disponueshme, të qasshme dhe të verifikueshme në çdo kohë.
3. Planifikimit dhe prioritizimit të duhur të banorëve rezidentë duke siguruar segmentimin sipas rregullores së re dhe njëkohësisht të plotësoj dokumentacionin për lejet e parkimit aktuale, të cilat janë të mangëta me dokumente në mënyrë që secili qytetar të jetë i pajisur në mënyrë të drejtë me leje parkimi dhe në rastet e parregullta, të bëjë revokimin e lejeve.
4. Sigurimit që tarifat e përcaktuara për veturën e parë dhe të dytë të zbatohen në mënyrë rigoroze, duke shmangur përjashtimet dhe keqpërdorime.
5. Hartimit të një plani detaj për shenjëzimin horizontal dhe vertikal, për të siguruar shenjëzim të dukshëm dhe adekuat të parkingjeve të menaxhuara nga Ndërmarrja..
6. Vendosjes së politikave të qarta dhe të dokumentuar për autorizimet e përdoruesve të sistemit, veçanërisht për zyrtarët që kanë qasje për të bërë ndryshime të gjobave dhe të krijohen dhe implementohen kontrole të brendshme efektive për të monitoruar dhe gjurmuar/verifikuar çdo veprim lidhur me anulim, rivendosje apo ndryshim të gjobave. Të vendos njëkohësisht autorizime dhe plane të qarta për kontrollorët dhe dispeçeret.
7. Sigurimit të mbledhjes së të hyrave nga gjobat të cilat anulohen si rezultat i përfundimit të orarit duke gjetur modalitet për arkëtimin e këtyre mjeteve.
8. Të implementoj proces të qartë dhe kontrole adekuate rreth të hyrave dhe parave të gatshme, të vendos formularë zyrtarë për pranim-dorëzimin e parasë së gatshme për të përmirësuar kontrollin financiar. Si dhe të siguroj funksionimin efikas të teknologjisë aktuale e cila përdoret për menaxhimin e duhur të parkingjeve përfshirë procesin e të hyrave financiare.
9. Zhvillimit dhe zbatimit të procedurave dhe udhëzimeve të qarta për kontrollorët e Ndërmarrjes në përputhje me rregulloret komunale. Këto procedura duhet të sigurojnë përputhjen me kërkesat rregullatore për monitorimin, inspektimin dhe raportimin mbi aktivitetet e parkimit.

